



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 19.11.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj - kryetare e Komisionit

Rendi i ditës :

Seancë dëgjimore me Drejtorinë e Përgjithshme të Emergjencave Civile për shqyrtimin e projektligjit “Për buxhetin e vitit 2020”.

Marrin pjesë:

Ermonela Felaj, Myslim Murrizi, Elona Hoxha, Sadi Vorpsi, Antoneta Dhima, Luan Duzha, Luan Harusha, Spartak Braho, Elena Xhina, Anduel Xhindi, Eljo Hysko, Edmond Rrushi, Lefter Maliqi, Nimet Musaj, Ylli Shehu, Arlind Çaçani.

Mungojnë:

Alban Zeneli, Xhemal Qefalia, Paulin Sterkaj dhe Arben Elezi.

Të ftuar:

HAPET MBLEDHJA

Ermonela Felaj – Mirëdita të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e radhës së Komisionit për Sigurinë Kombëtare. Në rendin e ditës kemi një dëgjese me Drejtorinë e Përgjithshme të Emergjencave Civile për buxhetin e vitit 2020.

E kemi bërë si rregull të punës së këtij komisioni që disa nga institucionet të cilët kanë përgjegjësi, që impaktojnë pjesë të gjera të popullsisë në të kemi pasur gjithmonë në komisionin tonë edhe pse më herët është dëgjuar institucioni epror. Dje kishim rastin të diskutonim me Ministrinë e Mbrojtjes për buxhetin e planifikuar për këtë institucion për vitin 2010. Në pyetjet e drejtuara përfaqësuesve të Ministrisë së Mbrojtjes, njëra prej tyre ishte edhe ajo që lidhej me buxhetin për emergjencat civile.

Prezenca e drejtorit të Përgjithshëm të Emergjencave Civile, zotit Çako dhe e zotit Laknori si drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar do të na ndihmojë më shumë për të kuptuar se cili është buxheti që planifikohet për Drejtorinë e Përgjithshme të Emergjencave Civile, nëse ky buxhet është i mjaftueshëm për t'i adresuar sa dhe si duhet të gjitha nevojat e këtij institucioni.

Pa humbur kohë do të doja t'ia kaloja fjalën zotit Çako. Ndërkohë, kujtoj kolegët se relator për këtë pjesë do të jetë zotit Luan Harusha.

Haki Çako - Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar deputetë,

Më lejoni, që duke përfituar nga rasti së pari t'ju falënderoj për mbështetjen, por edhe për dakordësinë e miratimit të ligjit nr. 45 të vitit 2019 "Për mbrojtjen civile" si një nga ligjet më të rëndësishme të miratuara nga parlamenti shqiptar gjatë vitit 2019 i vendosur në prioritet nga qeveria shqiptare, por edhe nga të gjitha grupet parlamentare në komisionet përkatëse.

Dua të theksoj se pa kontributin, mbështetjen e të gjithë deputetëve, sigurisht që ky ligj nuk do të arrihej të konkludonte. Ky ligj prej 15 gushtit të vitit 2019 ka hyrë në fuqi si një nga ligjet më të rëndësishme, i cili na barazon, por edhe na mundëson analogjinë dhe zhvillimin në përputhje të plotë me të gjithë partnerët tanë, por edhe drejt integritit në Bashkimin Europian në një nga prioritetet më të veçanta që ka lidhje me sistemin e mbrojtjes civile, por edhe me reduktimin e riskut si një nga parimet bazë të këtij ligji për të mundësuar ngritjen e të gjitha strukturave përkatëse, për të krijuar mekanizmin për

mbrojtjen civile, për të investuar paraprakisht, për të prevaluar mbi të gjitha fenomenet e fatkeqësive natyrore që karakterizojnë Shqipërinë si një nga 10 vendet me risk të lartë në të gjithë Bashkimin Europian, por edhe një nga 40 vendet me risk të larë në shkallë globale.

Më duhet të theksoj se çështja e buxhetit, por edhe e vlerësimit të mbrojtjes civile është shumë e rëndësishme, aq sa janë të rëndësishme vetë angazhimi dhe koshienca e të gjitha institucioneve dhe organizmave që janë pjesë e këtij sistemi. Duke e qartësuar përfundimisht konceptin se mekanizmi i mbrojtjes civile është një sistem i tërë brenda të cilit janë të ndërthurura të gjitha buxhetet e të gjitha institucioneve pa përjashtim, pika mbi “i” i vihet edhe buxhetit të përlllogaritur ose të planifikuar, të programuar për Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile tashmë e filluar që në emërtim, e përcaktuar në ligj, e cila ka bërë të mundur transformimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile.

Më lejoni që të bëj një hyrje të përgjithshme të shkurtër duke raportuar se ne tashmë jemi në një fazë shumë të rëndësishme të konkludimit dhe të realizimit të kësaj reforme, prioritet i vendosur nga Kryeministri i Shqipërisë dhe nga qeveria lidhur me mbrojtjen civile dhe me të gjithë sistemin që do të krijohet, duke qenë se aktet normative që pasojnë në zbatimin dhe zbërthimin e ligjit janë po aq të rëndësishme sa vetë ligji për t’i implementuar dhe për ta bërë atë jetik lidhur me përballimin e të gjitha fatkeqësive natyrore që karakterizojnë Shqipërinë.

Vetëm për vitin 2019 jemi karakterizuar nga një sërë fenomenesh të fatkeqësive natyrore, të cilat kanë dashur angazhimin e një sërë strukturave, por edhe të buxheteve të rëndësishme të rialokuara nga Ministria e Financave dhe nga qeveria shqiptare, lidhur me masat që janë dashur për të kompensuar ose për t’u ardhur në ndihmë të gjithë qytetarëve që janë prekur në mënyrë të vazhdueshme, duke filluar nga reshjet e dendura të janarit të vitit 2019, në bllokimin e akseve kryesore të rrugës, ku është investuar fuqishëm në të gjitha institucionet, por edhe me të gjithë mekanizmat që kanë mundur hapjen e rrugëve për ardhjen në ndihmë të banorëve dhe të qytetarëve që kanë pasur bllokim të tyre. Duke vazhduar më pas me fatkeqësinë natyrore siç ishte tërmeti i 1 qershorit në qarkun e Korçës. Më pas me një sërë fenomenesh të zjarreve, të cilat kanë dëmtuar jo pak sipërfaqe të konsiderueshme në shumë pyje, në kullota dhe në pemëtari. Pastaj, sikurse kemi qenë të gjithë në dijeni edhe me fenomenin e tërmetit të 21 shtatorit të vitit 2019 në rajonin e Durrësit dhe në rajonin e Tiranës. I përmenda këto duke dashur të them se ka qenë një vit jashtëzakonisht i ngarkuar me fenomene të fatkeqësive natyrore të cilat, sa nuk janë të

lidhura me pozicionin gjeografik të Shqipërisë, e cila është një zonë sizmike e konsideruar e riskut të lartë në Ballkan, sikurse edhe vende të tjera fqinje si Greqia dhe Turqia, por janë fenomene që në shumicën e rasteve jo vetëm që nuk mund të parashikohen si fenomene, por nuk mund të parashikohet edhe në planifikimin e buxheteve, që do të duhen të alokohen apo të rialokohen për të marrë masa.

Në këtë kuadër, më lejoni të theksoj dhe t'ju bëj me dije se qeveria shqiptare në tërësinë e investimeve për vitin 2019 deri në këto momente që po raportoj ka investuar rreth 1 miliardë e 017 lekë. Nëse duhet, unë mund t'ju detajoj. Duke filluar që nga 79 milionë lekë të investuara në rehabilitimin, rindërtimin dhe rikonstruksionin e banesave të Korçës, 470 miliardë të akorduara nga fondi i veçantë i kontigjencës së qeverisë shqiptare dhe 91 milionë të akorduara nga buxheti i emergjencave civile në Ministrinë e Mbrojtjes në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, ashtu sikurse kemi investuar 338 milionë të akorduara në buxhetin e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile për rehabilitimin e një sërë lumenjsh në të gjithë juridiksionin shqiptar, ku vazhdon puna intensive për rehabilitimin e digave për të parandaluar përmbytjet si një nga fenomenet të cilat kanë karakterizuar dhe vazhdojnë të karakterizojë vendin tonë.

39 milionë lekë janë livruar për kompensimin e fatkeqësive të ndryshme në të gjitha qarqet dhe bashkitë, ku qytetarë të ndryshëm kanë pasur fatkeqësi të djegies së banesave apo fatkeqësi të shkëputura, spontane, ndryshe nga fatkeqësitë masive.

Në këtë kuadër, buxhetin për vitin 2019 në tërësi, qeveria shqiptare e ka pasur në prioritet, në vëmendje. Kjo është një vlerë që krahasimisht me të gjithë vitet e tjera prevalon në mënyrë të dukshme, pasi në vitet e tjera kemi pasur një buxhet më të limituar dhe vlera reale që kemi akorduar apo kemi investuar ka qenë shumë herë më e vogël.

Viti 2019 në raport me vitin 2020.

Ne vazhdojmë të mbartim një detyrim të konsiderueshëm, i cili është rreth 722 milionë lekë lidhur me dëmshpërblimin e një sërë fenomenesh dhe fatkeqësish të tjera natyrore, të cilat po ashtu transferohen në detyrime buxhetore të vitit 2020, sikurse janë mbartur në vitin 2019, janë të përcaktuara në zëra konkretë dhe në varësi dhe në përputhje me mundësitë financiare janë në konsideratë në Ministrinë e Financave për të bërë të mundur kompensimin pjesë - pjesë, pasi sasia është e konsiderueshme dhe dëmshpërblimi i menjëhershëm është i pamundur për çdo kapacitet financiar.

Për sa u përket zërave të tjerë, artikulli 62 "Mallra dhe shërbime të tjera" përdoret për shërbime, transporte, karburante, pjesë këmbimi, siguracione, shpenzime për qiramarrje,

shpenzime të tjera operative, shpenzime për udhëtime, për materiale zyre dhe për kancelari. Fondi në dispozicion për këtë artikull për vitin 2019 është 54 milionë dhe do të duhet të alokohet përsëri.

Artikulli 604 “transferta korrente të brendshme”, fondi i këtij artikulli 130 milionë lekë është parashikuar dhe është realizuar për dëmshpërblimin e familjarëve, sikurse e përmenda më sipër. Edhe pse fondi i përcaktuar për këtë qëllim është realizuar për vitin buxhetor, nevojat janë të lidhura ngushtë me debinë, me detyrimin e mbartur në vite që nga viti 2012 dhe deri tani.

Artikulli 605 “Transfertat korrente të jashtme”, të planifikuara në vlerën 4 milionë lekë përdoren për likuidimin e detyrimeve financiare vjetore prej 25 mijë eurosh të shtetit shqiptar si anëtar në iniciativën DPPI, iniciativa për parandalimin dhe gatishmërinë në Europën Juglindore, bazuar në nenin 11 të memorandumit të mirëkuptimit të ligjit nr. 135, datë 09.10. 2014 “Për ratifikimin e memorandumit të mirëkuptimit në kuadër institucional të iniciativës së gatishmërisë për parandalimin e katastrofave në Europën Juglindore”.

Detyrimet e krijuara mbartin rreth 722 milionë të specifikuara, nëse do të duhen me zëra, por totali i detyrimeve është ky që thashë më lart. Janë përfshirë të gjitha llojet e fatkeqësive, duke filluar që nga përmbytjet e vitit 2013, përmbytjet e janarit të vitit 2016, përmbytjet e vitit 2017, përmbytjet, e tërmeti i vitit 2018, sepse ka pasur dhe një sërë fenomenesh të tjera që kanë përfshirë, kanë prekur rajone, bashki të ndryshme dhe prefektura si ajo e Dibrës, e Elbasanit, dhe e Vlorës.

Më duhet të theksoj se Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile bazuar dhe në studimet e bëra ka përcaktuar dhe nevojat prioritare përveç detyrimeve të mbartura që lidhen kryesisht me rehabilitime për përpunimin e sistemit të mbrojtjes dhe të rrëshqitjes në njësi të ndryshme. Janë hartuar, janë marrë në konsideratë dhe janë studiuar që të gjitha projektet e bashkive. Është bërë një planifikim, i cili konsiston në vlerën prej 353 milionë lekësh për 17 projekte. Në mënyrë të detajuar dhe hap pas hapi priten mundësitë e rialokimit të fondeve për t’i akorduar këto fonde në implementimin e këtyre projekteve.

Dua të theksoj edhe një herë se jemi në një fazë shumë të rëndësishme të implementimit të ligjit, të krijimit të strukturës së AKMC-së, e cila është dakordësuar që të ketë të gjitha strukturat përkatëse për të përballuar, por edhe për të qenë menaxherja kryesore e qeverisë shqiptare në zhvillimin e politikave të reduktimit të riskut dhe të mbrojtjes civile, ashtu siç e parashikon ligji nr.45 i vitit 2019, edhe VKM-ja për funksionimin e kësaj agjencie. Në bazë të ligjit, sikurse kemi diskutuar edhe në komisionin

përkatës edhe në Komisionin e Sigurisë fillimi i funksionimit të AKMC-së daton më 1 janar të vitit 2010, i cili do të bëjë të mundur edhe funksionimin e plotë të kësaj agjencie me të gjithë strukturën përkatëse në bazë të gjitha detyrimeve të përcaktuara në ligj, ashtu sikurse që të gjitha detyrimet e tjera ligjore të përcaktuara në afat kohor, të gjitha aktet normative do të kërkojnë dhe e kanë të domosdoshme përcaktimin e buxheteve. Në këto kushte, duke qenë se shumë struktura nuk janë ende efikase nuk është e mundur që të përcaktojmë një buxhet fiks konkret, por gjatë marrjes së vendimeve të Këshillit të Ministrave do të përcaktohen hap pas hapi të gjitha nevojat buxhetore financiare për çdo zbatim të ligjit nr. 45.

Faleminderit.

Ermonela Felaj - Faleminderit, zoti Çako!

Fjalën e ka zoti Harusha.

Luan Harusha - Faleminderit, zonja kryetare!

Falënderoj zotin Çako për parashtrimin e buxhetit të emergjencave civile!

Sic e dimë ka kaluar rreth një vit e gjysmë që përgjegjësia për emergjencat civile bashkë me Drejtorinë e Përgjithshme të Emergjencave Civile kanë kaluar te Ministria e Mbrojtjes. Tani kemi një ligj të ri për mbrojtjen civile që përcakton qartë përgjegjësitë në rastet e emergjencave civile për çdo institucion qendror vendor deri te subjektet private.

Megjithatë për mua sektori i emergjencave civile nuk ka marrë një vëmendje siç duhet. Kjo pasi Shqipëria një vend që përballet me një shkallë shumë të lartë rreziku nga fatkeqësitë natyrore, kësaj i shtohet edhe ajo që është bërë gjatë gjithë këtyre viteve të tranzicionit, ku humbi çdo kontroll mbi territorin.

Më vjen mirë që në lidhje me emergjencat civile projektbuxheti i vitit 2020 parashikon një rritje krahasuar me vitin e kaluar. Por personalisht mendoj se rritja përsëri nuk është e mjaftueshme. Unë doja të dija nga ju zoti Çako, nëse është e mjaftueshme apo jo.

Në lidhje me detyrimet e mbartura ndaj qytetarëve ndër vite, ju thatë se janë 722 milionë lekë borxh, a keni menduar si të kompensohen këta qytetarë?

Ligji “Për mbrojtjen civile” parashikon ngritjen e një agjencie kombëtare për mbrojtjen civile. Dua të di, a është ngritur kjo agjenci, nëse po nga buxheti i emergjencave i shkon kësaj agjencie?

Çfarë masash keni marrë për përballimin e rasteve të emergjencave, pasi jemi në sezonin e dimrit? Për shembull, në Shkodër, pasi unë vij nga ai qytet, ndodhin shumë fatkeqësi natyrore.

Ermonela Felaj - Faleminderit, zoti Harusha!

Relacioni këtë herë ishte ndërtuar në një formë tjetër, në formën e pyetjeve, që na japin shkas të hapim diskutimin duke nisur nga pyetjet e zotit Harusha. Pastaj të gjithë kolegët mund të bëjnë pyetje.

Luan Harusha - Në përmbytjet e vitit 2011 në Shkodër u ngrit një bajpas për mbrojtjen e qytetit, kanë filluar punimet, por që nga vitit 2011 e deri sot nuk janë përfunduar. Ai jo që nuk mbron qytetin, por rrezikon më shumë përmbytjen e qytetit, sepse të gjithë ujërat përballen aty, mbesin aty dhe nuk kanë asnjë rrjedhje në lumë apo në liqenin e Shkodrës.

Ermonela Felaj - Po, zoti Çako.

Haki Çako - Faleminderit!

Ju falënderoj zotit Harusha për vlerësimin!

Jam i sigurt se hap pas hapi ne jemi po aq të informuar të gjithë së bashku lidhur me rëndësinë, por edhe angazhimin për implementimin e ligjit, sikurse e përmenda më sipër. Është e vërtetë se 722 milionë të akumuluar si detyrim të AKMC-së njihen tashmë dhe janë planifikuar, është në vëmendjen e Ministrisë së Financave. Është një detyrim, i cili do të mundësohet në mënyrë të përshkallëzuar për shkak të vlerës së konsiderueshme, duke marrë në konsideratë edhe fatkeqësitë që ndodhin gjatë rrugës, ose gjatë vitit sikurse ishin ato që përmenda gjatë vitit 2019. Shpresojmë dhe urojmë që viti 2020 të karakterizohet me sa më pak fatkeqësi, të cilat do të na mundësojnë për të kompensuar edhe barrën e detyrimeve të mbetura. Gjithsesi, të gjitha dosjet, dokumentacioni përkatës për të gjitha fatkeqësitë që janë përpiluar mbi bazën e punës së bërë nga komisionet e vlerësimit në bashkitë respektive, janë të identifikuar, të administruara dhe hap pas hapi sipas mundësisë financiare do të bëhet edhe trajtimi.

Lidhur me çështjen e ngritjes së agjencisë, automatikisht në pjesën kalimtare të ligjit është përcaktuar se Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile transformohet në AKMC, institucionalisht ky institucion quhet AKMC. Në këtë kontekst ne kemi hartuar të gjitha draftvendimet e Këshillit të Ministrave qoftë për strukturën, qoftë për funksionimin, por edhe për fillimin e kësaj agjencie në mënyrë buxhetore më 1 janar të vitit 2020 sipas ligjit nr.45. Besoj se jemi në rrugë të mbarë. Do të mundësojë një sërë avantazhesh lidhur me vlerësimin, vëmendjen, por edhe në raportet ndër-institucionale për detyrimet që ata kanë.

Do të doja të kërkoja edhe ndihmën tuaj. Kam biseduar edhe me deputetët, edhe me kryetarin për të bërë të mundur sensibilizimin e të gjitha institucioneve lidhur me funksionimin e kësaj reforme të ligjit, por edhe të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile.

Kryetarja e komisionit e ka pasur në vëmendje dhe unë e falënderoj.

Lidhur me masat për parandalimin e përmbytjeve për sezonin e dimrit është hartuar një plan masash. Ne si AKMC në Ministrinë e Mbrojtjes, në mënyrë të vazhdueshme permanente jemi në kontakt me të gjitha strukturat përkatëse të emergjencave në prefektura dhe në bashki, të cilat kanë hartuar plane masash në mënyrë të detajuar për masat që duhen marrë për parandalimin e përmbytjeve.

Që nga fillimi i vitit 2018, mbase të favorizuar edhe nga koha, por, gjithsesi, janë bërë një sërë investimesh që lidhen me parandalimin e përmbytjeve, ashtu siç vazhdon edhe implementimi i një sërë projektesh të AKMC-së me projektet e BE-së dhe Komisionit të KE-së, siç është *Pro News, To be Ready* dhe një sërë projektesh që lidhen me hartëzimin e zonave të përmbytura nga lumenjtë.

Jam në dijeni të një projekti shumë të rëndësishëm që po implementon Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore lidhur me studimin e të gjithë lumenjve. Ky është një projekt shumë ambicioz i BE-së, i cili mundëson studimin e detajuar, por edhe masat dhe investimet konkrete për të gjithë lumenjtë, kryesisht Drini, Buna, Vjosa, Semani (janë gati 5 lumenj).

Lidhur me bajpasin e Shkodrës është hartuar një projekt. Ka filluar një investim për të vendosur një barrierë. Nga informacionet tona di që aty ka një papajtueshmëri të nevojës lidhur me projektin, ka një implementim joreal, ka probleme zbatimi i projektit për shkak të lartësisë së digës apo marrjes në konsideratë të disa elementeve të barrierës me xhama apo me beton. Nuk po hyj në detaje, sepse nuk jam ekspert i inxhinierisë dhe nuk marr përsipër të diskutoj për një projekt që nuk e disponoj.

(Diskutime pa mikrofon)

Ermonela Felaj - Faleminderit!

Urdhëroni, zoti Murrizi!

Myslim Murrizi - Faleminderit!

Zoti drejtor i përgjithshëm, unë shoh se buxheti i emergjencave civile për vitin 2020 është 315 milionë lekë të reja apo 2,6 milionë euro, afërsisht.

A e zgjidh ky buxhet të gjithë deficitin e ngelur nga vitet, përmbytjet në vitet 2016, 2017, 2028 dhe dëmet e fundit të tërmetit të shtatorit në Durrës dhe Tiranë, por sidomos në

zonën e Korçës, ku janë rrëzuar shtëpitë? Këto janë jashtë këtij buxheti apo janë planifikuar të jenë brenda këtij buxheti?

2,6 milionë euro për një institucion siç është AKMC-ja (dhe jo pak përmytje ka ky vend) më duket një shumë e vogël dhe nuk mendoj se përballon dëmet nga historiku i përmytjeve dhe i fatkeqësive natyrore ndër vite.

E dyta, doja të dija se nga dëmet e prapambetura, që është premtuar nga të gjitha qeveritë me radhe se do t'i dëmshpërblejë, a ka dobi në të ardhura nga njësitë lokale vendore në institucionin e emergjencave civile, që janë vlerësuar si dëme dhe janë në dosje që flenë të padëmshbërblyera sipas ligjit?

Sa është e llogaritur nga AKMC-ja shuma e dëmit të shkaktuar në zonën e Korçës, por edhe në zonën Durrës- Tiranë?

Nga përmytjet që kemi pasur në Shkodër, Fier dhe Vlorë është shkaktuar një dëm i konsiderueshëm të fermerët. Me mijëra hektarë tokë janë përmytur bashkë me prodhimet, bagëtitë dhe dëme të tjera të këtij lloji. A do të ishte më mirë që ju të ishit iniciuesi i një ligji, dhe ne ta mbështesnim, që detyron kompanitë e sigurimeve që të pranojnë sigurim për fatkeqësi natyrore të bujqësisë, sepse nuk i pranojnë sot që po diskutojmë? Pra, a do të ishte mirë të iniciohej një ligj i tillë nga ana juaj, se kështu do të bonte edhe barra fiskale e shtetit?

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Murrizi për pyetjet!

Urdhëroni, zoti Çako!

Haki Çako - Faleminderit!

Për vitin 2020 vlera e përcaktuar nuk është ajo që përputhet me detyrimet që ne mbartim, por edhe me atë çka mund të parashikohet realisht, sepse një pjesë është e paparashikueshme.

Ne jemi të interesuar dhe kemi parashikuar që në mënyrë të përshkallëzuar të mundësojmë shlyerjen e detyrimeve të mbartura. 722-milionëshi i përfshin të gjitha detyrimet duke pasur parasysh se ndër vite të gjitha dosjet e detyrimeve janë përpiluar nga komisionet e bashkive dhe janë të administruara në AKMC.

Ka pasur një vlerësim lidhur me 2 fatkeqësitë natyrore të tërmetit të 1 qershorit të vitit 2019 në Korçë dhe të 21 shtatorit në Durrës dhe Tiranë. Duke pasur para sysh nevojën emergjente të sistemimit, stabilizimit dhe të vendosjes së atyre banorëve, (duke u dhënë prioritet absolut banorëve që u janë dëmtuar plotësisht banesat) ne, në bashkëpunim të

ngushtë me prefekturën, por edhe me institucionet e tjera, si Ministria e Infrastrukturës, Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Brendshme kemi iniciuar tre standarde të kësaj situate.

Kjo lidhet me një rindërtim të banesave, të cilat janë të banueshme. Në qarkun e Korçës janë duke mbyllur procesin e rindërtimit rreth 39 banesa (për bashkinë Korçë, Ersekë dhe për bashkinë Devoll). Ndërsa 80 banesa janë ristrukturuar thellësisht me buxhetin tonë (40 milionë të qeverisë shqiptare dhe 37 milionë të donacioneve të ndryshme në zërin buxhetor të emergjencave civile).

Krahas këtyre dy detyrimeve, pjesa tjetër e banesave të cilat janë dëmtuar pjesërisht ose me dëmtime të lehta janë, gjithashtu, pjesë e fokusit të detyrimeve që ne mbartim, janë dosje që nuk kanë përfunduar ende plotësisht për të bërë një bilanc përfundimtar për shkak të volumit të tyre.

Këto janë pjesë e detyrimit të VKM-së nr. 329, e cila përcakton detyrimin e qeverisë ose në rastin konkret të AKMC-së për kompensim, jo për detyrim.

Më lejoni të sqaroj kontekstin e shprehjes “dëmshpërblim” në raport me “kompensim”! Shpesh përdoret shprehja “dëmshpërblim”, e cila është një detyrim ligjor i një institucioni, individi apo një subjekti ndaj një tjetri për shkak të dëmit të shkaktuar, por, në rastin konkret, fatkeqësitë natyrore nuk janë dëm i shkaktuar nga institucione apo persona fizikë e juridikë. Qeveria në VKM-në nr. 329 ka marrë në konsideratë faktin e kompensimit, ashtu si çdo qeveri tjetër.

Asnjë banor, asnjë qytetar, asnjë shtetas shqiptar, i cili ka paraqitur ankesë apo ka pasur dëmtime sado të vogla nuk është lënë në harresë, ai është vlerësuar nga komisionet përkatëse të vlerësimit me ekspertë, inxhinierë dhe me grupe vlerësimi. Dosjet përkatëse kanë një set të caktuar dokumentacioni dhe këto dosje shihen nga ekspertët AKMC-së në mënyrë të detajuar dhe pasi plotësohen, ato konfirmohen nga prefekti përkatës dhe administrohen nga ne.

Sot mund t’ju informoj se ka filluar puna për rindërtimin e 233 banesave të dëmtuara nga tërmeti në bashkitë Durrës, Shijak, Krujë, Rrogozhinë, Kavajë dhe Kamzë, ashtu sikurse një pjesë ka marrë përsipër bashkia e Tiranës dhe ka filluar rindërtimin e disa banesave në disa zona rurale.

Vlera totale e dëmit lidhet ngushtësisht me administrimin e tërësisë së dosjeve që do të duhet t’i vërë në dispozicion AKMC-së, por për momentin nuk jam në gjendje të jap një vlerë të saj.

Jam shumë i qartë lidhur me interesin dhe vlerësimin tuaj lidhur me dëmet e shkaktuara fermerëve nga përmbytjet. Ky është një dëm kolosal shpeshherë. Fatkeqësisht, baza ligjore nuk ekziston për të kompensuar drejtpërsëdrejti fermerët, të cilët kanë investuar kursimet e tyre në ferma të ndryshme dhe bëhen pre e përmbytjeve.

Fermerët kërkojnë mbështetje, por ne jemi po aq të interesuar sa edhe ju në iniciativën për të miratuar një projekt mbi një ligji, i cili do të detyrojë në mënyrë absolute të gjitha kompanitë e sigurimeve të marrin përsipër sigurime për fatkeqësitë natyrore për të gjithë fermerët.

Jam i bindur se kjo është e lidhur ngushtë edhe me kulturën tonë sa i përket nevojës për t'u siguruar, pasi shpeshherë sigurojmë makinën dhe nuk sigurojmë shëndetin.

Ne jemi të gatshëm, hap pas hapi, edhe me mbështetjen tuaj, për të marrë iniciativa për të hartuar një ligj lidhur me sigurimet edhe të fermerëve, por edhe të të gjithë biznesmenëve dhe subjekteve të tjera.

Faleminderit!

Ermonela Felaj - Faleminderit!

Urdhëroni, zoti Maliqi!

Lefter Maliqi - Faleminderit!

Faktikisht, edhe në pasqyrimin që ju i bëtë punës së kësaj agjencie ndër vite, tek të gjitha qeveritë është parë angazhimi publik i të gjitha strukturave që përmban kjo agjenci e emergjencave civile. Kemi parë edhe forcat e ushtrisë, shtabet e emergjencave në bazë shtabi apo prefekturë, forcat e Policisë së Shteti e të gjitha me radhë, por nga raportimi që ju bëtë këtu dhe nga ajo që shohim ne, përsëri unë kam bindjen totale se edhe ky parashikim i buxhetit për AKMC-në mendoj se është i pamjaftueshëm për fatkeqësitë natyrore që mund të ndodhin gjatë këtij viti, jo më për të dëmshpërblyer dëmet e mbartura ndër vite.

Problemi nuk qëndron vetëm te shou që bëjnë qeveritë, se puna reale juaja apo e vartësve tuaj ka qenë për t'u falënderuar, por te premtimet që jepen nga qeveria për dëmshpërblimet e banorëve në këto fatkeqësi natyrore.

Unë do të ndalem konkretisht tek tërmeti që ra në Korçë, ku premtimi ishte se ndërtimi i shtëpive do të kishte mbaruar para disa muajsh dhe nuk e di deri ku kanë arritur punimet, ndërkohë që përveç kësaj, në dijeninë time, pjesa më e madhe e pushtetit lokal në Shqipëri, bashkisë së Korçës i kanë akorduar, me vendime këshillash, disa fonde për ndërtimin e banesave të dëmtuara nga tërmeti.

Pse nuk kanë përfunduar këto punime? E njëjta situatë është edhe në Durrës dhe Tiranë, prandaj kam frikë se këto mund të jenë vetëm premtime në letër.

Struktura juaj a ka nevojë për më shumë njerëz në administratën që ju drejtoni? A ka ndonjë ndryshim se çfarë privilegjesh ose çfarë mundësish reale ka zhvendosja e strukturës nga Ministria e Brendshme te Ministria e Mbrojtjes?

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Maliqi!

Urdhëroni, zoti Çako!

Haki Çako – Unë mund t'ju informoj se të gjitha banesat që janë konsideruar të pabanueshme në qarkun e Korçës janë duke përfunduar. Këto janë banesa, të cilat janë përcaktuar me komisionet e vlerësimit, me inxhinierë, me topografë, pra me të gjithë ekspertët përkatës, komisione të ngritura në bazë të ligjit nga bashkitë përkatëse.

Ritheksoj se janë planifikuar për rindërtim 39 banesa. Janë në përfundim 37 banesa dhe 2 banesa në Devoll sapo kanë filluar. Ky rindërtim nga e para është bërë mbi bazën e kontributeve dhe solidaritetit të kompanive ndërtuese në dakordësi me AKMC-në dhe me Ministrinë e Infrastrukturës, ashtu sikurse nga 80 banesa të dëmtuara rëndë po rikonstruktohen, 73 prej tyre janë përfunduar, 5 janë në ndërtim e sipër dhe 2 banorë nuk kanë rënë dakord (pasi familjari duhet të plotësojnë një deklaratë) dhe ato kanë marrë përsipër ta ndërtojnë vetë.

Bashkia e Korçës ka fondet e veta për të gjitha kompensimet, rindërtimin dhe restaurimin. Ne nuk kemi akorduar ndonjë fond. Fondi që është menaxhuar për rindërtimin dhe për rikonstruksionin është menaxhuar nga Ministria e Mbrojtjes dhe AKMC-ja me një memorandum të përbashkët, të miratuar nga ministri i Mbrojtjes bashkë me tre kryetarët e bashkive, të Korçës, të Ersekës dhe të Devollit.

Pjesa tjetër që ka dëmtime të lehta do të administrohet dhe trajtohet në bazë të VKM-së nr.329. Angazhimi i qeverisë është thuajse i realizuar në Korçë dhe për këtë ju siguroj.

Sikurse e thashë, në zbatim të ligjit nr. 45 është detyrim ngritja, funksionimi dhe krijimi i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile. Në koncept ka filluar funksionimi me të njëjtën strukturë që ka pasur që, për hir të së vërtetës, ka qenë jo minimale, por shumë e vogël në raport me interesin, me vëmendjen, apo me të gjitha prioritetet, që ka pasur për emergjencën civile dhe mbrojtjen civile. Duke qenë se detyrimet e ligjit nr. 45 janë të gjithanshme në hartimin e draft-strukturës së AKMC-së janë marrë në konsideratë të gjithë

kapitujt dhe komponentët e ligjit, që do të thotë se janë ideuar strukturat, të cilat do t'u përgjigjen në mënyrë respektive të gjitha detyrimeve që ka ligji, duke filluar nga prioriteti i reduktimit të riskut, i parashikimeve, i koordinimit ndërinstitutional, i vlerësimit të dëmeve e deri te vërtetimi i riskut.

Por një rëndësi e veçantë i është kushtuar hartimit dhe ngritjes së Drejtorisë së Projekteve dhe bashkëpunimit ndërkombëtar për çështjen e mbrojtjes civile dhe të gjitha investimeve që do të duhen, por edhe të të gjitha detyrimeve që mbart kjo agjenci. Nuk është sekret t'ju them se, të paktën nga propozimi i bërë nga ministrja, është parashikuar një kapacitet prej rreth 100 vetë që të angazhohen në të gjithë agjencinë për të shlyer detyrimet ligjore. Tashmë është në fazën e konsultimit struktura me institucionet kryesore, si DAP-in, Ministrinë e Financave dhe shumë shpejt do të kalojë në qeveri për miratim.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Po, zoti Duzha!

Luan Duzha – Faleminderit, zonja kryetare!

Ju faleminderit drejtor, për të gjithë paraqitjen!

Kam një pyetje. Ju thatë që janë rreth 17 projekte që presin rehabilitimin dhe financimin e tyre. Çfarë janë këto projekte? Janë projekte të realizuara nga ju për rehabilitim, apo nga bashkitë dhe ju është paraqitur?

E dyta, ju thatë gjithashtu se po ndërhyhet te lumenjtë e mëdhenj, si Drini, Vjosa, por për përrrenjtë malorë a ka ndonjë projekt, se në përrrenjtë malorë, për pritrat malore, ka mbi 30 vjet që nuk vihet dorë?

Unë jam deputet i Bashkisë së Cërrikut dhe në komunën Mollas është përroi i Selitës pritrat e së cilës janë të degraduara pothuajse totalisht dhe në rast të reshjeve të dendura rrezikon gjysma e fshatit.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Luan Duzha – Lidhur me 17 projektet e hartuara, ju informoj se janë projekte të hartuara nga bashkitë respektive mbi bazën e nevojave të përcaktuara për emergjenca. Ne nuk hartojmë projekte, se nuk është në përgjegjësinë tonë, por bëjmë vlerësimin dhe administrimin e projekteve dhe, mbi bazën e fondeve të rakorduara e të mundësuar nga qeveria, ne akordojmë këto projekte. Mund të përmend rehabilitimin e kodrës së Shtufit në Gjirokastrë, projekt që u vlerësua nga ne iu akordua fondi përkatës Bashkisë së Gjirokastrës dhe u bë i mundur rehabilitimi. Ky është detyrimi ynë ligjor.

Sigurisht edhe për përrrenjtë, ashtu si dhe për lumenjtë, duke qenë se janë burimi kryesor i mbartjes së lumenjve, dalja nga kontrolli i përrrenjve është e pasojë e jashtëzakonshme qoftë në erozionin që krijon në pyje, por edhe në zona të caktuara të banuara. Ne kemi informacionin e mjaftueshëm për përrrenjtë, si për zonën e Cërrikut, ashtu dhe për zonën e Elbasanit dhe të gjitha shqetësimet janë të administruara, por janë një sërë institucionesh të tjera që kërkohet të jenë të angazhuara, pse jo dhe drejtpërdrejt, në hartimin e projekteve përkatëse për rehabilitimin e tyre dhe në investim, pasi në bazë të ligjit, por edhe të gjithë legjislacionit, bashkitë janë njësitë e pushtetit vendor, të cilat duhet të bëjnë jo vetëm vlerësimin, por shpeshherë edhe planifikimin e hartimin e buxheteve përkatëse për rehabilitimin e zonave të caktuara, që krijojnë shqetësime, apo probleme.

Gjithsesi ne jemi në dispozicion të çdo projekti, që mundësohet nga bashkitë, kur del jashtë kapaciteteve të tyre ligjore financiare sipas përcaktimeve të bëra në ligj.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Duzha!

Meqenëse jemi te këto pyetje, doja të bëja një ndërhyrje, po e diskutoja edhe më herët me zotën Murrizi, sipas ligjit të ri “Për emergjencat civile” i bie që buxheti që shteti dedikon për përballimin e emergjencave civile të jetë realisht shumë herë më i madh se buxheti që ju akordon juve si AKEC për faktin se këto bashki kanë detyrimin e 4 përqindëshit nga buxhetet e tyre për emergjencat civile, por të mos harrojnë se edhe ministritë duhet të planifikojnë 2-4 % të buxhetit të tyre për zvogëlimin e riskut nga emergjencat. Po mundoheshim të bënim një llogari dhe do të doja konfirmimin tuaj se sa vëmendje keni pasur ju në këtë drejtim. Në projektligjin për buxhetin e vitit 2020 thuhet se shpenzimet e buxhetit vendor për vitin 2020 janë parashikuar në shumën 57,128 miliardë lekë. Pra po të marrim 4 % të kësaj shifre, i takon që të jenë vetëm për emergjencën civile.

E dyta, a ka pasur një vëmendje nga ju, nuk e di, në fakt, se ndoshta duhet t’u hynim detajeve të ligjit, se kush është duke e ndjekur detyrimin e ministrive sipas ligjit, që ato të përcaktojnë në buxhetin e tyre 2% deri në 4% për emergjencat civile? Se mendoj se duhet të ketë një vëmendje në këtë drejtim.

Nuk e di nëse është autoriteti që ju përfaqësoni, i cili e ndjek këtë gjë, por me gjasë jo, sepse nuk jeni në kushte që t’u kërkon llogari ministrive, por patjetër që duhet të ketë një vëmendje.

Ne do ta ushtrojmë përgjegjësinë tonë. Nuk ka qenë ndonjëherë traditë në Komisionin e Sigurisë që të vijë ministri i Financave madje me këtë rast unë dua të marr edhe mendimin e kolegëve nëse mund ta thërrasim ministrin e Financave për të orientuar

vëmendjen në një pikë shumë të rëndësishme, pasi të kemi përfunduar dëgjuesën me të gjitha institucionet e sigurisë për buxhetin.

Buxhet për emergjencat jepen, por për faktin se ky orientohet në disa drejtime, në finale ne duhet të kemi një produkt që të dimë se kaq para janë planifikuar dhe mundet fare mirë që këto para të shërbejnë edhe për përballimin e atij borxhi, që ju me të drejtë thoni se po e mbartni, por buxheti që ju akordohet vit pas vitit, edhe pse me rritje, nuk ju lejon ta shlyeni. Janë 722 milionë lekë të reja. Si do të shlyhen ato nëse nuk ka një përgjegjësi për të gjithë sasinë e të hollave, që jep shteti për përballimin e emergjencave civile?

Do të doja një opinion tuajin, zoti Çako, mbase edhe zoti Laknori mund t'ju ndihmojnë. Ideja është të ndihmojmë në mënyrë të ndërsjellë.

E para, ne e kuptojmë drejt dhe e dyta, kërkojmë llogari aty ku duhet, për menaxhimin e gjithë kësaj shifre.

Haki Çako – Faleminderit, zonja kryetare!

Lidhur me angazhimin e të gjitha institucioneve për përballimin e emergjencave civile ligji i ri “Për ngritjen e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile” adreson disa detyrime për të gjitha institucionet, si bashkitë dhe institucionet qendrore të Republikës së Shqipërisë. Nga buxhetet e këtyre institucioneve duhet të jenë të detajuara 2% deri në 4% për përballimin e emergjencave civile.

Në kuadër të shqyrtimit të këtyre buxheteve, me kryesimin e Ministrisë së Brendshme, është ngritur një grup ndër-institucional pune, ku është pjesë edhe Ministria e Mbrojtjes me ekspertë të buxhetit, por edhe nga AKMC-ja, që do të shohë pjesën detajimit të kësaj pjese të buxhetit, që është dedikuar për parandalimin e emergjencave civile. Kjo është më shumë në suazën e parandalimit të emergjencave civile dhe do të adresojë një pjesë të mirë të përballimit të emergjencave civile në Republikën e Shqipërisë.

Ermonela Felaj – Mendohet që kjo punë të vlejë për fillimin e vitit që vjen?

Haki Çako – Po.

Ermonela Felaj – Grupi i punës është ngritur me urdhër të Kryeministrit?

Haki Çako – Është ngritur me urdhër të ministrit të Brendshëm.

Ermonela Felaj – Nuk e kuptoj pse është përfshirë ministri i Brendshëm në krye, kur emergjencat janë përgjegjësi e tjetër ministrie? A mund të kemi një sqarim për këtë?

Haki Çako – Urdhri i ministrit të Brendshëm presupozon kontrollin e detyrave të deleguara të pushtetit vendor. Por gjithsesi dua të sqaroj se lidhur me buxhetet e parashikuara në ligjin nr. 45 “Për mbrojtjen civile” është një detyrim, i cili nuk është konceptuar ende as

nga institucionet dhe as nga pushteti vendor dhe ky është një fakt, ndaj unë e vlerësova shumë idenë tuaj për të bërë të mundur ndërgjegjësimin.

Pikë sa pari, thelbi i gjithçkaje shkon të financat dhe shumë bashki kanë paqartësi dhe na janë drejtuar neve por gjithsesi do të duhet t'i drejtohen Ministrisë së Financave si institucioni përgjegjës buxhetor financiar i qeverisë shqiptare dhe është pikërisht ajo që duhet të vendosë ekuilibra mes institucioneve, por edhe detyrimin financiar që ato kanë për të parashikuar fonde të caktuara për mbrojtjen civile, në rastin konkret, 2%-4% të përcaktuar në ligj. Pikërisht ky institucion ka dakordësuar kalimin e ligjit. Shpesh vjen pyetja dhe kërkesa nga bashki të caktuara që ne nuk e kemi në tabelën përkatëse parashikimin e fondit 4%, ndërkohë që bashkitë e kanë detyrimin 4% në vit dhe në përfundim të vitit, nëse nuk kanë investuar 4% për shlyerjen e dëmeve, do t'u duhet të mbarin edhe një 4 përqindësh tjetër për një vit tjetër, pastaj, në pamundësi të justifikuar financiare, do të duhet ta transferojnë detyrimin te ne.

Detyrimi aktual i mbartur në bazë të ligjit të vitit 2001, do të na mundësojë deri më 31 dhjetor të vitit 2019, pas 31 dhjetorit detyrimi financiar për të bërë kompensimin është i bashkive, flasim në aspektin ligjor, që do të thotë se pjesë e buxhetit, që po diskutojmë sot (në pamundësi për të bërë përmbledhjen, pra shifrën) janë edhe të gjitha buxhetet e institucioneve dhe të bashkive e tjera, nëse ne do ta fokusojmë investimin e drejtpërdrejtë në mbrojtjen civile, për reduktimin e riskut dhe për masat që duhen marrë për parandalimin dhe menaxhimin e fatkeqësive natyrore. Në këtë kuptim unë do të doja vëmendjen tuaj për të adresuar edhe te Ministria e Financave një vlerësim të caktuar lidhur me këtë çështje. Shumë institucione do të duhet të jenë të vëmendshme dhe të përgjegjshme përpara ligjit, për të përcaktuar 2% deri në 4% të buxhetit të tyre sipas ligjit.

Normal që këto institucione në aspektin formal mund t'i kontrollojmë ne, por në aspektin financiar i kontrollon Ministria e Financave.

Ermonela Felaj – Dakord.

Besoj se do ta kemi të nevojshme ta thërrasim ministren e Financave për këtë problem dhe për të tjerë që mund t'i gjykojmë pasi t'i mbarojmë dëgjesat me çdo institucion.

Po, zoti Murrizi.

Myslim Murrizi – Ajo që po shoh tani është se buxheti i shtetit për të gjithë pushtetin lokal është 571 miliardë lekë, ose 448 milionë euro për 61 bashkitë. 4 përqindëshi i tyre i planifikuar sipas ligjit që kaluam këtu për emergjencën civile, për parandalimin, për

kompensimin shkon 18 milionë euro, pra gati 7-fish më i lartë se i gjithë buxheti që keni ju dhe kjo kërkon praninë e ministres së Financave këtu, që të fillojë një fushatë ndërgjegjësimi.

Çfarë tagri keni ju, sepse të gjithë qytetarët ju drejtohen juve për çdo dëm që kanë dhe thonë që nuk po na jep rrugë, nuk po na jep paratë etj? Ata duhet ta dinë nëpërmjet medieve, nëpërmjet jush, por edhe nëpërmjet nesh. Ndoshta siç kemi inspektuar drejtoritë e policive vendore, mund të marrim një nismë edhe me qarqet dhe të gjithë kryetarët e bashkive të qarqeve le të jenë bashkë. Të bëhen me dije bashkë me ju që kaq para keni për këtë punë. Ata kanë 7-fishin e buxhetit tënd dhe 3-4 milionë shqiptarë e dinë që për çdo dëm që ndodh përgjegjës jeni ju. Në fakt, ju jeni 1/7-ta e buxhetit që me ligjin e ri u shkon 61 bashkive. Jam dakord që këtu duhet të vijë ministrja e Financave për të diskutuar me detaje.

Faleminderit!

Ermonela Felaj - ...ka qenë gjithmonë shumë i gatshëm dhe i hapur për të bashkëpunuar me ne. Ne kemi folur edhe këtu në komision, kemi pasur rast të flasim me drejtorin, që një nga punët që duhet të bëjë komisioni, edhe pse nuk na ka premtuar koha për shkak të ngarkesave, është ndërgjegjësimi i bashkive për këtë detyrim që u ngarkon ligji “Për emergjencat civile”.

Mendoj që sapo të mbarojmë detyrimet që kemi për diskutimin në parim të buxhetit, i cili parashikohet deri në datën 2 dhjetor, të përpiqemi që të paktën në javën e dytë të dhjetorit të bëjmë diçka në këtë drejtim ende pa u bërë miratimi në parim në parim, që shkon në datat 19-20 dhjetor.

Fjalën e ka zoti Arusha, më pas zonja Gjebrea.

Luan Harusha – Një pyetje kam, zoti Qato. Këto përqindjet e buxheteve, i shpenzojnë bashkitë, apo merren vesh me ju se ku duhen çuar përpara? A janë të lidhur me ju për problemet e zonave ku do të shpenzohen këto para?

E dyta, unë nuk e di pse shkon te bashkitë ky problemi i përqindjeve? Le t’u shkojnë direkt këtyre se këto janë institucione për atë punë. Ata t’i marrin problematikat për të gjitha bashkitë, se janë të specializuar!

Ermonela Felaj – Ata do të dilnin superministri më vete. Ligji i ri operon me këtë logjikë, edhe në kuadër të decentralizimit dhe të pavarësisë që gëzojnë bashkitë për të menaxhuar territorin dhe të gjitha problematikat. E rëndësishme është që ato të kenë instrumente financiare dhe ne për këtë po diskutojmë. Agjencia ka kryesisht rol koordinues dhe është zëdhënëse sipas nevojave.

Luan Harusha – Është e mjaftueshme për të përdorur këto.

Ermonela Felaj – Mendoni që nuk e kishin fare dhe tani po ua vëmë, është një hap i parë. Megjithatë le t’ia japim fjalën zotit Çako dhe e diskutojmë, por ligji këtë detyrim u jep bashkive dhe ne e kemi miratuar këtë gjë.

Luan Harusha – Dakord, por ky është institucioni më i specializuar për atë pjesë.

Ermonela Felaj – Të dëgjojmë zotin Çako, se ai është më afër problemit dhe mund të na ndihmojë më shumë me përgjigjet!

Luan Harusha – Edhe ministritë e kanë të detyrueshme këtë 2%- 4%?

Ermonela Felaj – Po.

Haki Çako – Më lejoni ta theksoj edhe një herë: vlera absolute e ligjit nr. 45 “Për mbrojtjen civile” është pikërisht kjo, pra që detyrimi është shpërndarë mbi bazën e parimit të subsidiaritetit jo vetëm financiar, por edhe të angazhimeve të tjera të të gjitha strukturave, duke filluar nga njësitë e pushtetit vendor. Duke qenë se një bashki ka në strukturën e vet të gjithë menaxhimin e buxhetit, që buron nga të ardhurat dhe nga të gjitha format e ndryshme ligjore, por ka edhe të gjitha resurset e nevojshme të burimeve njerëzore, apo kapacitete të tjera për të funksionuar, atëherë këtu fillon detyrimi ligjor.

Ne duhet të kuptojmë që gjithkush duhet t’i dalë zot vetes, AKMC-ja nuk ka mundësi të mbulojë, të reagojë, të mendojë ose të hartojë projekte edhe sikur ta bëjmë me mijëra vetë. Kjo lidhet ngushtësisht edhe me atë që thashë, pra që ne nuk mund të hartojmë projekte. Unë nuk e di se çfarë shqetësimi ka në Tropojë, apo në Cërrik, sepse është i zoti i shtëpisë që duhet t’i dalë për zot. E thënë ndryshe, që gjithkush, me të ardhurat e veta dhe me mundësitë që ka, duhet të parashikojë fatkeqësinë, si një familje që dikur parashikonte 5 lekë të ardhura për rast fatkeqësie dhe për të menaxhuar të gjitha mundësitë e veta, por kur del jashtë kapaciteteve jemi ne koordinatorë, jemi institucioni që ndërvepron dhe që ndërlidh.

18 milionë plus 2%-4% të institucioneve është një vlerë e jashtëzakonshme. Ju siguroj që nëse të gjitha njësitë e pushtetit vendor dhe institucionet, do të planifikojnë dhe do të investojnë, nuk po them 4%, por 2%, se deri tani ligji e ka të parashikuar deri në 2%, do të ishte shumë mirë. 99% e njësive nuk parashikonin dot gjë, 0% dhe nuk shpjegohet ndryshe që një bashki kishte në fondin e vet vetëm 7 milionë lekë të vjetra të parashikuara për përballimin e fatkeqësive natyrore. Ky është fatalitet. Një lum, një përrua, apo një rrugë a i ka? A i ka dy pallate?

Gjithsesi, në këtë aspekt, lidhet ngushtësisht edhe me konceptin e ligjit për çështjen që thashë më parë. Është një sistem i tërë dhe ne duhet ta ngremë sistemin e mbrojtjes civile, që gjithsecili, në funksionimin e vet, të jetë piramidë e vogël dhe të gjitha piramidat bashkë të

formojnë piramidën e madhe, që është e gjitha një sistem. Por në sistem duhet të jenë edhe financat, se nuk duhet që ngrenë përherë sytë nga Ministria e Mbrojtjes, apo nga AKMC-ja, e cila, në fund të fundit, është një institucion që bën politikat e qeverisë. Jo të presin të gjithë nga qeveria, aq më tepër që në ligj është parashikuar fare qartë, 4% nga fondi i dedikuar. Qeveria thotë: unë po t'i jap lekët, por këtë 4% ti duhet ta planifikosh këtë punë. Pastaj mënyrën për ta implementuar e kemi për detyrë ta kontrollojmë dhe ta shohim. Ata duhet të justifikohen ose duhet të sqarojnë ligjërisht çdo investim që lidhet me çështjen e mbrojtjes civile.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Besoj se është e qartë. Ne edhe nga ky rast duhet të rrisim sinjalizimin se është e nevojshme të zbatohet ligji tani, jo thjesht të shkruhet. Është përshëndetur, janë mbajtur konferenca për ligjin për emergjencat civile. Tani është momenti të sigurohemi që ligji zbatohet nga bashkitë dhe institucionet. Madje, do të thosha që vëmendja jonë duhet të shkojë tek institucionet qendrore, sepse pengesat, që bashkitë të mos bëjnë të kundërtën e asaj që thotë ligji, i kemi vendosur. Është prefekti i pari që nuk e miraton buxhetin dhe, së dyti, fond që nuk përdoret për emergjencat civile, digjet. Kështu që je i interesuar që realisht 4% t'i dedikosh ose duke blerë borëpastruese, ose zjarrfikëse, duke ndërhyrë në një argjinaturë ose në ndonjë digë, në çfarëdolloj gjëje ku të vjen rreziku.

Ndërkohë, Ministria e Financave duhet të na garantojë që ministrinë që përmend ligji, ta bëjnë vërtet këtë pjesë. Në qoftë se duhet t'i japim vlerë gjithë punës që është bërë me ligjin, është pikërisht tani momenti. Është logjike që duhet të involvohen të gjithë për t'i përballuar emergjencat dhe nuk duhet të kemi pikë dyshimi, se kudo të ndodhin emergjencat nuk mjafton vetëm një strukturë, që të dedikohet për ta përballuar atë, por duhen edhe më shumë se kaq. Madje, ligji parashikon edhe vullnetarizmin, sepse ndonjëherë mund të tejkalohej edhe kapacitetet që ka shteti atë vit për emergjencat civile.

Po, zonja Gjebrea. Ndjesë!

Elona Gjebrea – Faleminderit, zonja kryetare!

I nderuar zoti drejtor,

Në radhë të parë ju falënderoj për gjithë prezantimin e detajuar për buxhetin për emergjencat civile! Është fat që Drejtoria e Emergjencave Civile ka një kapacitet si ju, për sa i përket menaxhimit dhe eksperiencës që keni në drejtim.

Kam dy pyetje. Në fakt, një e kam sugjerim, në vijim edhe të asaj që u diskutua këtu nga zonja kryetare, nënkryetari dhe gjithë anëtarët, për fondin e detyrueshëm për emergjencat civile nga bashkitë.

Nuk mendoj që ne jemi në atë fazë maturie, ku çdo ministri dhe çdo bashki ta bëjë punën perfekt, ashtu siç duhet. Pra, i takon institucionit tuaj të mbledhë dhe të kordinojë punën. Ndoshta një konferencë e përbashkët për këtë qëllim, me mbështetjen tonë si parlamentarë, mund të vlente, që të kemi një ndërgjegjësim, një kërkesë llogarie, si dhe një plan pune, që duhet të vihet në zbatim për implementimin e ligjit të emergjencave civile.

Jam dakord me ato që tha kryetarja. Për sa kohë ne kemi një ligj të ri, kemi detyrimin që edhe ta zbatojmë këtë ligj. Ky është momenti të bëjmë edhe një ndryshim nga ajo çfarë është bërë. Jo më kot u krijua kjo strukturë, sepse u pa që struktura ekzistuese nuk ishte e mjaftueshme për të përballuar emergjencat civile. Të mos harrojmë se Shqipëria, ashtu sikurse vendet e tjera, do të përballlet me ndryshime klimatike, për të cilat janë dhënë tashmë alarme përmes shumë fenomeneve të pandodhura më parë. Kështu që, nuk presim të kemi situata të qeta. Ne do të presim situata të paparashikueshme dhe prandaj duhet të jemi të përgatitur më parë. Këtë e them edhe si raportuese e komisionit të dytë në delegacionin parlamentar të OSBE-së.

Në rezolutën e fundit, që është miratuar nga Asambleja Parlamentare e OSBE-së verën e kaluar, është theksuar nevoja për përballimin e situatave të emergjencave nga ndryshimet klimatike. Ndoshta është mirë që një kopje të kësaj rezolute ta keni, sepse është edhe një detyrim i vendeve anëtare të OSBE-së që të zbatojnë dhe të implementojnë rezoluta të miratuara nga ata.

Po përfitoj këtu, ndoshta po e kaloj pak fjalën për sa i përket OSBE-së, për t'ju kujtuar se Shqipëria do të marrë edhe presidencën e ardhës të OSBE-së në vitin 2020. Kështu që na takon të jemi edhe pararojë për sa u përket detyrimeve që kanë rezolutat dhe direktivat e këtij institucioni kaq të rëndësishëm.

Pyetja e dytë ka të bëjë me donacionet, me mbështetjen e huaj. Në fakt, po shikoja financimin e huaj. Këtu kemi një tabelë të buxhetit të vitit 2020, 2021 dhe 2022. Më bën përshtypje që në vitin 2020 kolona për financimin e huaj është zero dhe në vitin 2021 dhe 2022 është 300 mijë të reja. Kam një pyetje: pse është zero 2020-ta dhe pse e kemi fiks financimin e huaj në dy vjetët e ardhshëm?

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Gjebrea!

Po, zoti Çako.

Haki Çako – Faleminderit, e nderuar zonja Gjebrea!

Ne kemi punuar bashkë dhe është kënaqësi... Unë e vlerësoj jashtë mase kontributin tuaj në ligj, por edhe këndvështrimin tuaj për çështjen e mbrojtjes civile!

Është e padiskutueshme që pa një koncept të qartë, pa një perceptim të qartë të detyrimit për të përballuar fatkeqësitë natyrore dhe sidomos mbrojtjen civile, për të krijuar tamam sistemin e mbrojtjes civile, nga të gjitha institucionet, nga të gjitha njësitë administrative, nuk do të mund të arrijmë të jemi në gjendje as të implementojmë buxhete, as të përballojmë...

Nga natyra, fatkeqësitë natyrore, përveçse sjellin pasoja të jashtëzakonshme, në momente të caktuara sjellin edhe panik, që shpeshherë është armiku kryesor në menaxhimin e këtyre fatkeqësive. Ndaj, edhe buxhetet e të gjitha institucioneve (sigurisht, edhe të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile) janë të lidhura ngushtësisht me masat dhe detyrimet paraprake për t'i bërë njerëzit sa më të përgjegjshëm për të reaguar në momente të caktuara. Edhe në ligj, edhe në strukturë, ne kemi parashikuar një qendër tregtare për edukimin, trajnimin, por edhe për sensibilizimin e të gjitha institucioneve, të personave juridikë/fizikë dhe qytetarë. Besoj se jemi në fazat e para të këtij procesi. Kjo lidhet ngushtësisht edhe me momentin e ngritjes dhe të funksionimit të agjencisë kombëtare.

Aktualisht, jemi në fillesa dhe kapacitetet e burimeve njerëzore të institucionit që unë drejtoj janë po ato që kanë qenë, për të mos thënë... Shpresoj që shumë shpejt të plotësohen. Është e rëndësishme të plotësohen, në idenë time, por edhe tuajën dhe të ligjit, me ekspertë, pasi këto fusha kërkojnë ekspertë të mirëfilltë, kërkojnë njerëz me formim dhe kapacitet për të studiuar dhe vlerësuar gjithë situatën.

Lidhur me donacionin dhe financimet e huaja që janë parashikuar, mbase mund të jetë një lapsus në parashikim, por mund të them që ne vazhdojmë në implementimin e projekteve të huaja, sikurse është *Pronews*-i dhe *To be ready*. Janë disa projekte, të cilat vazhdojnë të implementohen. Janë pjesë e procesit. Është një projekt 3-1-1, *risk management and protection*, në kuadrin e Interreg-ut për financimin nga Bashkimi Europian. Parashikohet me një vlerë rreth 1 milion e 737 mijë euro si projekt. Ashtu sikurse dihet, është në proces *Pronews*-i. Ka qenë për t'u finalizuar në maj të vitit 2019, por për disa problematika që pati vetë konsorciumi i projektit brenda për brenda, ky projekt, në mungesë të realizimit final të një prej komponentëve, u mundësua të shtyhej.

Ne jemi duke rehabilituar 40 stacione hidrometeorologjike në shkallë vendi, me financimin e delegacionit të Bashkimit European. Parashikohen 380 mijë euro për rehabilitimin e këtyre stacioneve. Përfituese është Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, IGJEUM-i, Instituti i Gjeoshkencës dhe Mjedisit. Po ashtu, është një projekt i përbashkët, 1,353, për parandalimin e zjarreve, edhe ky i financuar nga Bashkim i European, mundësuar në bashkëpunim me Greqinë, ashtu sikurse është edhe një projekt trelateral, Shqipëri, Itali, Mali i Zi, për çështjen e zjarreve, por edhe për ndotjen e detit.

Jemi në proces me një sërë projektesh të tjera, të cilat nuk mund të parashikohen si investime të huaja, për shkak të fazave në të cilat ndodhen aktualisht, por me shtimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe të mundësive të tjera të agjencisë, jam i bindur... Para një jave kam qenë në një takim me drejtorin e përgjithshëm të mbrojtjes civile europiane në Bruksel. Aty gjeta gatishmëri absolute, duke qenë se raportova për gjithë procesin e reformës legislative dhe strukturore që kemi filluar. Ai u tregua absolutisht i gatshëm për të mundësuar çdo lloj suporti për çështjen e mbrojtjes civile. Po kështu, edhe me departamentin e mbrojtjes civile italiane kemi gatishmëri dhe marrëdhënie shumë të mira për të suportuar... Sigurisht, këto janë suporte teknike, që lidhen ngushtësiht më shumë me gatishmërinë tonë se tyren. Besoj se lidhet edhe me raportin e OSBE-së, që ju e thatë.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, kolegë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po....

Haki Çako – Shtimi i...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ai do të vijë menjëherë me vendimin e Këshillit të Ministrave, sepse pa u miratuar buxheti nuk mund të parashikosh vlera. Është ajo që e thashë, jemi në fazën e konsultimeve me institucionet. 5 më lart ose më poshtë, nuk jemi në gjendje të përcaktojmë në mënyrë specifike se sa do të duhen, por, natyrisht, është parashikuar në ligj dhe qeveria është e gatshme dhe do t'i suportojë, patjetër.

Ermonela Felaj – Dakord...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Çako, fiken mikrofonin, që të mund të flasë zoti Maliqi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, për këtë nuk funksionon.

Lefter Maliqi – Kam një sqarim teknik, meqë u fol më shumë nga ju, kryetare, dhe nuk e kemi zotin Vorpsi këtu, ish-prefekt.

Buxhetin e pushtetit lokal, më shumë për kulturë, prefekti nuk mund ta bllokojë dot me ligj. Prefekti, për mua, funksionon si Presidenti, pra është këshilli bashkiak ai që bllokon fondin e bashkisë, buxhetin e bashkisë. Prefekti, edhe në qoftë se nxjerr ndonjë arsye, në seancën e dytë, në mbledhjen e dytë të këshillit bashkiak, kalon... E njëjta gjë si Presidenti me parlamentin, kur miratojmë një ligj, nuk e dekreton Presidenti, nuk e kalon dhe më pas automatikisht kalon... Thjesht për...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ermonela Felaj – Dakord.

Kolegë, besoj se nga të gjitha diskutimet, pyetjet dhe sqarimet, që u bënë gjatë ditës së sotme, mbërrijmë në një kërkesë ose në nevojë të përbashkët, që, për të mundësuar një performancë më të mirë të Agjencisë Kombëtare të Emergjencave Civile, duhet të kërkojmë edhe një dëgjuesë me ministren e Financave, për nevojat që i përmendëm pak më parë dhe nuk duhet t'i përsërisim.

Atëherë, ju ftoj për votimin në parim. Besoj se jemi të gjithë dakord dhe e mbështesim. Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Faleminderit, zoti Çako!

Do t'ju lutesha kolegëve, vetëm 1 minutë...

Nesër parashikojmë 3 seanca dëgjimore për buxhetin.

Në orën 10:30 do të kemi SHISH-in. Relator për këtë do të jetë zoti Duzha.

Në orën 11:30 është Shërbimi i Inteligjencës së Ushtrisë. Relator do të jetë zoti Vorpsi.

Në orën 13:30 (kjo ishte mundësia e vetme për të pasur këtë seancë) me ministrin e Brendshëm. Relatore do të jetë zonja Gjebrea.

Nga komisioni do t'ju vihet në dispozicion një material me të dhënat e buxhetit të shtetit për secilin nga këto institucione.

Për Ministrinë e Brendshme keni një raport të përmbledhur të të gjitha konstatimeve që kemi bërë në drejtoritë e policisë së qarqeve ku kemi qenë. Ky material besoj se do t'ju shërbejë për pyetje, sepse mangësitë e punës që kemi vërejtur në drejtoritë e policisë apo në pikat e kalimit kufitar, sigurisht që nuk korrigjohen nëse nuk ka mbështetje buxhetore ose nëse nuk ka fokus në secilën prej atyre nevojave. Prandaj, besoj se edhe raporti

do t'ju vijë në ndihmë gjatë ditës së nesërme për të parashtruar të gjitha pyetjet tona. Mendoj se është më e dobishme kjo sesa shkresat që kemi bërë dhe nuk përtuar t'i kryejmë.

Po, zoti Murrizi.

Myslim Murrizi – Meqë do të jetë nesër drejtori i SHISH-it, ka rreth një muaj që ka një kërkesë nga gati 10 deputetë që të vijë në këtë komision dhe të raportojë për deklaratat publike të Presidentit të Republikës, që ka pasur informacion sekret apo të klasifikuar nga shërbime, se do të kishte revolucion të armatosur, do të kishte reprezalje, banda dhe “do të derdhej gjaku në gju të kalit” më 30 qershor.

Meqë do të vijë, është shumë e rëndësishme, përpos buxhetit, të sqarojë deputetët e Komsionit të Sigurisë Kombëtarë, kuptohet, ata që janë me certifikatë sigurie, se çfarë informacioni konkret ka ai për këtë, se ka 6 muaj që bëhet tollovi dhe sot ne medie prapë del që, në takim me disa kryetarë të partive politike shqiptare, kryetarët e partive kanë lançuar se Presidenti kishte një informacion të paparë për çfarë do të bëhej dhe se çfarë konspiracioni thuret në këtë vend. Ne jemi ligjvënës, jemi republikë parlamentare dhe nuk ka pse askush, institucion, individ, qoftë ky edhe drejtues institucioni, të mos vijë të japë llogari këtu sipas ligjit.

Ndaj, lajmërojeni! Ne kemi bërë dy kërkesa, një për drejtorin e SHIK-ut, një për drejtorin e DSIK-ës. Të mos na neglizhojnë, se, nëse mendojnë që nuk na pyesin, po ta them që sot se edhe unë nuk do t'i pyes nesër këtu, kjo është salla jonë e të qërohen jashtë me gjithë buxhet!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Murrizi!

Në fakt, nuk ka asnjë gjasë të ndodhë kjo, sepse janë kalendarizuar të dyja takimet, edhe takimi me drejtuesin e SHISH-it për problemin që ju i keni bërë kërkesë Komisionit të Sigurisë, edhe takimi me drejtuesin e DSIK-ës. Kështu që të dyja mbledhjet do të zhvillohen, por nesër këto janë mbledhje për buxhetin e këtyre dy institucioneve.

Ju faleminderit, kolegë!

Ditë të mirë!

MBYLLET MBLEDHJA